

# Biografia e Imzot Mark Sopi



**Imzot Mark Sopi** u lind më 26. 02. 1938 në fshatin Binçë të komunës së Vitisë nga prindërit Mëhilli dhe Maria. I takon një familje me tradita kombëtare dhe fetare. Në vendlindje kreu shkollimin fillore, kurse gjimnazin klasik në seminarin e Pazinit në Kroaci, ndërsa Fakultetin e filloi në Zagreb, ku i kreu dy vite të filozofisë, pas së cilave ipeshkvi Smiljan Franjo Çekada e dërgoi si student të dalluar për të vazhduar studimet në Romë. Studimet i ka përfunduar me sukses, duke vazhduar magjistruar me temën “Martirët e Karadakut”. U shugurua për meshtar në Romë, më 29. 06. 1968 dhe u emërua famullitar në Ferizaj si dhe iu besua detyra e sekretaritë të ipeshkvit, imzot Nikë Prelës në vitet 1968 - 1974. Në vitin 1974 u emërua famullitar në Zllakuqan që ishte famullia më e madhe në Kosovë, ku qëndroi deri në vitin 1991. Prej vitit 1991 shërbeu si famullitar në Durrës. Në nëntor të vitit 1995, Selia e Shenjtë e emëroi atë ipeshkëv të Kosovës, post në të cilin ai trashëgoi Imzot Nikë Prelën. Për shkak të rrethanave që ekzistonin në atë kohë në Kosovë, Imzot Mark Sopi është shuguruar për ipeshkëv në Romë në janar të vitit 1996 nga Papa Gjon Pali II.

Gjatë kohës së tij si Ipeshkëv i Kosovës, Imzot Sopi kontribuojë shumë në çështjen kombëtare duke vazhduar punën e suksesshme të paraardhësve të tij duke e forcuar edhe më tutje pozitën e Kishë në Kosovë. Ai ishte një zë i fuqishëm i shqiptarëve në përgjithësi e i katolikëve në veçanti duke përdorur një gjuhë të arsyeshme, të dialogut, mirëkuptimit dhe mençurisë. Këtë e dëshmoj më 18 maj 2005, para Kongresit amerikan. Me shumë urti Ipeshkvi ynë mbrojti Pavarësinë e Kosovës, si të vetmin faktor që do të stabilizoi tërë rajonin e Ballkanit. Ai më argumente e hodhi si të pa vërtetë, propagandën serbe për fundamentalizmin shqiptar, duke i lartësuar lartë vlerat dhe tolerancën fetare te shqiptarët.

Më emërimin e Imzot Sopi, në krye të Ipeshkvisë së Kosovës, më 1996, si trashëgimtarë i ipeshkvit dhe patriotit të madh të çështjes kombëtare Imzot Nikë Prelës, ishte punë e obligim pak i vështirë, rruga të cilën duhet ta ndjek edhe Imzot Mark Sopi, nuk do të ishte aspak e lehtë. Ishin këto vite të rënda për Kosovën, më plot sfida, në një kohë dhe rrethanë shumë të rënda për veprimtari kombëtare dhe fetare.

Sfida me të cilat u ballafaqua Imzot Mark Sopi ishin të shumta, por nder më të rëndësishme, për Imzot Mark Sopin ishte, përballja më të gjitha të këqijat e padrejtësitë që i bëheshin me dekada popullit shqiptarë në Kosovë nga pushteti sllavo komunist në një anë, dhe ruajtjen e grigjës se vetë, drejt rrugës se vërtetë të Zotit, në anën tjetër.

Imzot Mark Sopi, ishte i pa kursyer dhe u bë zëdhënës i kërkesave të shqiptarëve, duke internacionalizuar çështjen e Kosovës dhe te drejtën e

shqiptarëve për pavarësi. Në çdo hapë, në çdo takim, brenda dhe jashtë, dëshmoj se shqiptaret janë një komb, kanë një gjuhë e një gjak, ata nuk janë, as terrorist dhe as fundamentalist, por si për nga kultura, ashtu edhe orientimi i takojnë civilizimit Evropian. Duke kundërshtuar gjithë propagandën serbe, që shqiptaret i quante terrorist e fundamentalist dhe kundër civilizimit evropianë, këtë arriti ta dëshmoj me argumente nëpër qendrat e vendrojes dhe në Vatikan, se shqiptaret dëshirojnë pavarësinë dhe bashkimin në familjen Evropian, e kurrësi të formimit të një shteti të ri Islamik, në Evropë, siç e paraqitke propaganda serbe.

Sfidë tjetër për Imzot Mark Sopin ishin vitet 1997 deri 1999. Si të shpëtohet populli shqiptarë i pa mbrojtur, të cilit i kanosej zhdukja nga makineria vrastare e Beogradit. I cili zhvilloj një angazhim shumë të madh diplomatik duke paraqitur argumentet dhe gjendjen reale në Kosovë pran çarqeve relevante të qendrave të vendosjes.

Gjatë kohës së luftës Imzot Mark Sopin kishte vendim të prerë dhe urdhëroj që gjithë famullitaret në Kosovë duhet të qëndrojnë në famullitë e veta, pranë popullit të vet, në luftë e në zjarr. Objektet e shenjta, kishat katolike, të jenë vende strehimi për të gjithë shqiptaret pa dallim.

Sfidë tjetër për Imzot Mark Sopin ishte dhe përballja në kohën e komunizmi të ku u pengonte veprimtarinë që binin ndesh me platformën politike e filozofike të partisë komuniste. Mirëpo, edhe në këto momente delikate vërehet modestia dhe matura e tij prej një intelektualit të formuar, karizmat i lindur për drejtësi, për punë dhe seriozitet.

### **Veprimtaria e Imzot Mark Sopin**

Edhe veprimtaria e gjithanshme e Imzot Mark Sopit, në planin fetar, kulturor, shkencor, shoqëror e atë kombëtar, përputhet plotësisht me kohën kur kombit tonë po i përgatitej një rrezik i tmerrshëm, fund e krye ajo përshkohet me përpjekjet dhe aspiratat dhe të idealeve të mbarë popullit shqiptar. Prandaj, duke qenë personalitet më i shquar që iu përgjigj me devotshmëri kërkesave të popullit, që i ripohoi ato me një gjerësi dhe me një cilësi të shkallës më të lartë, duke ruajtur kontinuitetin e traditës. Imzot Mark Sopi konsiderohet përfaqësuesi më tipik i fesë, shkencës dhe i lëvizjes shoqërore-kombëtare të popullit tonë në një kohë të caktuar, si njëri nga përfaqësuesit më të denjë të epokës seculës i takoi. Në vitet e '90-ta, kur kauza kombëtare kërkonte veprimtarë të devotshëm në shërbim të kombit, këtij zëri iu përgjigj edhe imzot Mark Sopi, duke u radhitur njëri nga veprimtarët më të devotshëm në Lëvizjen e pajtimeve të gjaqeve të udhëhequr nga Profesori Anton Qeta dhe Don Lushë Gjergji. Ishte kjo koha kur uniteti i këtij populli kërkohet më tepër se kurdoherë, si parakusht për daljen nga ato kthetra që kishte mbërthyer këtë popull nga hegjemonia serbe. Nga ai kërkohet që kjo plagë shumëshkullore një herë e përgjithmonë të flaket nga ky popull. Pra, Imzot Sopi, gjatë gjithë veprimtarisë së tij për popullin shqiptar përcolli mesazhin për unitet, mirëqenie dhe harmoni, si parakusht për realizimin e aspiratës shumëshkullore. Kruga e tij ishte rrugë që i kishin preferuar etërit e kombit tonë, si Budi, Buzuku, Bogdani, Gjeçovi, Fishta e shumë të tjerë, idealeve të cilëve u mbeti besnik deri në frymën e fundit të tij.

Me mbërritjen e frymës së demokracisë në Shqipëri dhe përmbysjen e ideologjisë ekstreme komuniste, imzot Sopi së bashku me Mons Damjan Kurti, me qëllim për ta ndihmuar atë popull të vuajtur, shkoi në Shqipëri, përkatësisht në Durrës,

kur shërbeu për plot gjashtë vjet, duke lënë trashëgiminë e madhe të patriotit të flaktë, të besimtarit të madh, prelatit gojëtar, edukuesit të palodhur e dashamirës, misionarit të zellshëm që për një periudhë 6-vjeçare u bë famullitari më i dashur i Kishës Katolike në Durrës.

Është më të vërtetë madhështore ku qëndronte gjitha ajo energji dhe nga e gjente gjithë atë kohë për të gjitha ato veprimtari me të cilat merrej Imzot Sopi, Ripunoi me dashuri shkrimet e hershme dhe i përfshiu në librin e tij "Baca Kolë dhe famullitari" pastaj shkroi librin tjetër publicistik "Martirët e Karadakut", shkroi refleksionet për librin e profesorit skocez Drumond, përktheu letra e enciklika të Papës, në vitin 2000 botoi veprën »Koncilet ekumenike«. Ai shkroi edhe dhjetëra artikuj ne shtypin e kohës, sidomos të Shkodrës. Derisa veproi në Durrës, i dha jetë revistës kulturore "Vegim drite". Ai shkroi edhe shumë shkrime publicistike. Ka shkruar dhe botuar artikullin "Mall e nderime Kosove për imzot Lazër Mjedën."

I vetëdijshëm për numrin e madh të familjeve, e të te rinjve shqiptarë, që jetonin e vepronin në Evropë e më gjerë, Imzot Mark Sopi, së bashku më selinë e Shenjtë bënë shumë, që **Diasporën Shqiptare** mos ta lënë pa bari shpirtëror e kombëtar, arriti ta zgjeroi e profilizoi rrjetin e priftërinjve shqiptarë në diasporë, duke hapur qendra katolike shqiptarë nëpër shtete të ndryshme, të Evropës e deri në Amerikë.

Imzot Mark Sopi, ishte edhe nismëtari i parë për ndërtimin e katedrales "Nëna Tereze" në Prishtinë. Ai, bashkë më Presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën bëri edhe bekimin e parë të kësaj Katedrale, pra vuri gurë themelin të këtij tempulli të fesë dhe të kombit, ku theksonte se kjo është një lidhshmëri e së kaluarës historike më të tashmen dhe të ardhmen, zbardhje dhe kthim ka identiteti i shqiptarëve. Ngritja e Katedrales në Kryeqytetin e shtetit të Kosovës, për Imzot Mark Sopin kishte edhe një rendësi tjetër të veçantë sepse në Prishtinë duhet të rikthehet selia e Ipeshkëvisë së Kosovës. Kjo do jetë edhe qendër diplomatike, sepse më njohjen formale të pavarësisë, në Kosovë do të ketë lidhje të drejtpërdrejta si me shtetet e tjera të Evropës e botës ashtu edhe me Vatikanin. Kjo nismë e tij tashmë po bëhet realitet, pasi që punët e kësaj katedrale po shkojnë mjaft mbarë. Kështu, me këtë rast, do të realizohet ëndrra e Imzot Mark Sopit dhe e dr. Ibrahim Rugovës, po ashtu edhe e gjithë popullatës vullnetmirë të Kosovës dhe më gjerë.

I ndjeri Imzot Mark Sopit vdiq më 11. 01. 2006, rreth orës 15,00 nga një sulm në zemër, në spitalin e Prishtinës. I ndjeri Presidenti i Kosovës dr I Rugova, ditën e varrimit të Imzot Markut e pati shpall ditë zie për Kosovën. Varrimi i tij ishte vërtet madhështorë, dhe trupi i tij pushon në kishën tonë në Binçë, ku te varri tij vazhdimisht besimtarët lutën dhe ndezin qirinj. Pushoftë në paqe! Amen.

Fjalim i Imzot Mark Sopit përpara Komitetit të Kongresit Amerikan

video: <http://video.google.com/videosearch?q=mark+sopi>